



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

Drejtoria e Arsimit Parauniversitar

Nr.Prot.

Tiranë, më 30.12.2013



MIRATOHET

MINISTRI

LINDITA NIKOLLA

PROGRAMET E ARSIMIT BAZË

(Për fëmijët e ngujuar)

LËNDA: EDUKATA SHOQËRORE

KLASA I-V

Tiranë

Dhjetor 2013

I. SYNIMET E LËNDËS

Edukata shoqërore **synon**:

- të përgatisë të rinjtë dhe të rriturit për pjesëmarrje aktive në shoqërinë demokratike, duke fuqizuar kështu kulturën demokratike;
- të aftësojë të rinjtë në luftën kundër ksenofobisë, dhunës, racizmit, nacionalizmit agresiv dhe intolerancës;
- të sigurojë dhe të forcojë kohezionin shoqëror, drejtësinë sociale dhe në të mirën e përgjithshme;
- të fuqizojë shoqërinë civile përmes pajisjes së qytetarëve me njohuri dhe shprehje demokratike.

Mbështetur në këto qëllime të përgjithshme, **lënda e Edukatës shoqërore synon**:

- t'u japë nxënësve njohuritë dhe t'u zhvillojë aftësitë intelektuale, të domosdoshme për të kuptuar, analizuar dhe për të ndikuar në politikat sociale dhe mënyrat e zbatimit të tyre;
- të zhvillojë aftësitë e pjesëmarrjes qytetare të nxënësve dhe përfshirjen e tyre të vetëdijshme dhe të kualifikuar në zgjidhjen e problemeve të komunitetit;
- të zhvillojë përkushtimin qytetar në respektimin e vlerave dhe parimeve demokratike të domosdoshme për bashkëjetesë në një shoqëri demokratike.

2. KËRKESAT PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Programi i lëndës “Edukata shoqërore” për klasat 1-5 zhvillohet në 30 javë, në një orë mësimore në javë. Pra, numri i orëve gjithsej në të cilat zhvillohet programi i lëndës “Edukimi qytetar” është 30, nga të cilat, 60%-70% janë në funksion të trajtimit të koncepteve të reja, ndërsa 30%-40% shërbejnë për përpunimin e njohurive.

Dokumentet dhe burimet bazë qëduhet të njihen paraprakisht për zbatimin efektiv të programit janë korniza kurrikulare, standardet e fushës dhe ato të lëndës, të gjitha programet e lëndës së edukats shoqëroreimit qytetar për ciklin 1-9, programet e lëndëve të tjera, udhëzuesit lëndorë, manualët e vlerësimit.

Zbatimi i programit duhet të bëhet duke respektuar parimet e barazisë gjinore, etnike, kulturore, racore, fetare etj. Objektivat në programe përmbajnë njohuri, aftësi e qëndrime të karakterit të përgjithshëm, ndërlëndor dhe lëndor.

Objektivat grupohen në linja dhe renditja e tyre mund të ndryshojë kur gjykohet e nevojshme nga zbatuesit e programit.

Orët mësimore sugjerohen në kuadrin e linjave, ndërsa ndarja e tyre në funksion të njohurive të reja dhe të përpunimit të njohurive bëhet në bazë të raportit të përcaktuar më sipër. Zbatuesit e programit kanë të drejtë të ndryshojnë numrin e orëve të sugjeruara për linjat në masën 10%.

Përpunimi i njohurive përfshin:

- përsëritjen brenda një kapitulli të njohurive e të koncepteve themelore;
- integrimin e njohurive të reja të një kapitulli me njohuritë e kapitujve paraardhës;
- integrimin e njohurive të reja me njohuritë e lëndëve të tjera;
- përsëritjen vjetore (pavarësisht nga ndarja në linja ose në njësi tematike, lënda duhet parë si një e tërë);
- testimin e njohurive bazë;
- testimin vjetor (ky testim nuk është i detyruar);
- projekte qytetarie në të cilët integrohen aftësitë kërkimore shkencore me grupimet e tjera të aftësive.

3. METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES

Edukata shoqërore është një proces që zgjat gjithë jetën. Si i tillë ai është proces i të nxënës social, domethënë është të nxënë *për, në* dhe *rreth* shoqërisë, në të njëjtën kohë është të nxënës për të jetuar së bashku. Ai nënkupton demokratizimin e të nxënës duke u përqendruar te nxënësi dhe në pavarësinë e përgjegjësinë e tij në procesin e të nxënës, duke nënkuptuar me këtë edhe bashkërendimin e procesit të të nxënës dhe të mësimdhënies.

Edukata shoqërore arrihet nëpërmjet metodave të shumëllojshme e të ndërlidhura të të nxënësve, në të cilin ndërthuren lloje të tilla të edukimit si, për shembull, edukimi i të drejtave të njeriut, edukimi ndërkulturor, edukimi për paqe edukimi global, edukimit nëpërmjet medias etj.

Edukata shoqërore bazohet në përvojën dhe praktikën vetjake. Si i tillë ai kërkon një kurrikul të hapur që të përfshijë metodat pjesëmarrëse dhe ndërvepruese, të cilat bazohen në të nxënësve nëpërmjet përvojës, veprimtimit dhe bashkëveprimtimit

Pra, edukata shoqërore synon të zëvendësojë format tradicionale të mësimdhënies dhe të të nxënësve, në të cilat roli i mësuesit reduktohet në transmetimin e dijeve dhe të aftësive dhe ai i nxënësve në të dëgjuarit pasiv dhe, në rastin më të mirë, në përvetësimin e përmbajtjes së transmetuar. Edukimi për qytetarinë demokratike nënkupton mundësitë e shumta të të mësuarit që ofron “shoqëria e të nxënësve”. Ai del përtej kufijve të shkollës dhe të komunitetit dhe sfidon ndarjen që ekziston ndërmjet edukimit formal dhe atij joformal, ndërmjet veprimtarive kurrikulare dhe atyre jashtëshkollore, si dhe ndërmjet shkollimit dhe shoqërizimit. Si i tillë, ai zhvillon karakterin e ndërsjellë të procesit të mësimdhënies dhe të të nxënësve dhe nxit këmbimin e vazhdueshëm të rolit të mësuesve dhe të nxënësve. Në të njëjtën kohë, duke u përqëndruar në fitimin e aftësive dhe të kompetencave të nevojshme për veprimin dhe ndryshimin shoqëror, edukimi për qytetarinë demokratike ruan të gjitha karakteristikat e një përpjekjeje të paramenduar njerëzore që harmonizon teorizimet dhe diskutimin publik.

Në këtë kuadër, mësuesit duhet të shfaqen më tepër si organizatorë të mundësive të shumëllojshme të të mësuarit dhe si ura që lidhin burimet shoqërore me përdoruesit e tyre. Ata ndërmjetësojnë dhe lehtësojnë mundësinë e marrjes së informacionit dhe ndjekin në vazhdimësi sfidat e reja shoqërore, politike dhe teknologjike, si dhe nevojat gjithnjë në rritje të nxënësve të tyre. Nxënësve, gjithashtu, duhet të marrin pjesë aktivisht në vendimet lidhur me procesin edukativ, veçanërisht në ato që lidhen me përmbajtjen, metodat dhe strategjitë e mësimdhënies/të nxënësve për qytetarinë demokratike. Mësimdhënia duhet të bëhet një proces ndërveprues, në të cilin jo vetëm diskutohen qëllimet arsimore, por edhe njihen e shkëmbehen kolektivisht përvojat e fituara

Tërësia e procesit, përfshirë këtu dhe vlerësimin, karakterizohet nga marrëdhënie të ndërsjella. Vlerësimi i dyfishtë dhe përdorimi i të dhënave cilësore për të matur rezultatet

e të mësuarit ushtron ndikim të madh në procesin e mësimdhënies dhe të të nxënësve. Kjo praktikë bën që si mësuesit, edhe nxënësit të jenë të përgjegjshëm për veprimtarinë e tyre edukative dhe rezultatet e saj.

Një prej kërkesave më të rëndësishme në fushën e mësimdhënies është bindja e mësuesit në aftësinë e nxënësve për të mësuar dhe që ai vetë është i aftë t'i mësojë ose t'i ndihmojë për të mësuar. Të mësuarit për qytetarinë demokratike përfshin edhe aftësi të tjera të mësimdhënies që janë të rëndësishme për procesin e aftësimit të nxënësve për t'u bërë qytetarë të përgjegjshëm:

- aftësia për t'i parë problemet nga këndvështrimi i nxënësit, duke marrë parasysh prejardhjen, moshën dhe nivelin e tij arsimor, si dhe aftësia për të mos paragjykuar qëndrimet dhe perceptimet që janë të ndryshme nga të tjerat;
- aftësia për të kuptuar, pranuar dhe respektuar ngjashmëritë dhe ndryshimet që ekzistojnë ndërmjet mësuesve dhe nxënësve si dhe ndërmjet nxënësve;
- respektimi i të drejtave të nxënësve dhe ndjeshmëria ndaj nevojave dhe interesave të tyre;
- aftësia për të trajtuar çështje të diskutueshme dhe për t'u përballuar me situata problematike dhe komplekse që mund të ndeshen në mjedisin shkollor;
- aftësia për ta parë veten dhe nxënësin si pjesëmarrës aktiv në komunitetin lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar;
- bindja në mundësinë e progresit dhe që çdo individ mund të ndihmojë në arritjen e tij;
- aftësia për të integruar përparësitë vetjake në një kuadër të përbashkët problemesh e vlerash dhe për të zbatuar në praktikë vendimet e marra nga nxënësi;
- gatishmëria për të pranuar gabimet para grupit dhe për të nxjerrë mësim prej tyre;
- aftësia për të shtruar dhe debatuar haptazi për probleme të diktuara nga kurrikula e fshehtë.

4. VLERËSIMI

Standardet e përmbajtjes së lëndës së Edukimit qytetar përfshijnë tri elemente të ndërlidhur me njëri tjetrin: njohuritë, aftësitë intelektuale dhe ato të pjesëmarrjes dhe

prirjet qytetare. Të marrë së bashku këta elementë përbëjnë bazën për zhvillimin e edukimit qytetar dhe për rrjedhojë edhe vlerësimi i arritjeve të nxënësve duhet të pasqyrojë nevojën për të vlerësua shkëllën e përvetësimit të këtyre tri elementëve nga nxënësit.

Njohuritë përbëjnë thelbin e sistemit të vlerësimit dhe në përgjithësi mishërohen, për shembull, në pyetjet të tilla si:

- Cili është thelbi i qytetarisë dhe i jetës qytetare në demokraci?
- Cilat janë bazat mbi të cilat ngrihet sistemi demokratik në vend?
- Si dhe në çfarë shkalle sistemi politik në vend bazohet në qëllimet, vlerat dhe parimet e demokracisë të pranuar gjerësisht nga shoqëria jonë?
- Cili është roli i qytetarit në demokraci? Etj.

Aftësitë intelektuale dhe ato pjesëmarrëse të Edukatës shoqërore përfshijnë përdorimin e njohurive për të menduar në mënyrë kritike dhe krijuese dhe për të vepruar me efektshmëri e në mënyrë të arsyeshme për të përballuar e zgjidhur sfidat e jetës demokratike në vend.

Aftësitë intelektuale aftësojnë nxënësi të mësojnë dhe të zbatojnë njohuritë qytetare në funksionet e shumta dhe të ndryshme të qytetarit. Këto aftësi i ndihmojnë qytetarët të identifikojnë, të përfshkruajnë, të shpjegojnë dhe të analizojnë informacionin dhe argumentet si dhe të vlerësojnë, marrin dhe mbrojnë qëndrime të caktuar për çështje të jetës publike.

Aftësitë pjesëmarrëse aftësojnë qytetarët të monitorojnë dhe të ndikojnë jetën publike dhe atë qytetare duke bashkëpunuar me të tjerët, duke formuluar dhe shprehur qartë idetë dhe itneresat e tyre, duke bërë koalicione, kërkuar konsensus, duke bërë marrëveshje dhe duke menaxhuar konfliktet.

Një vlerësim tërësor në lëndën e edukatës shoqërore nënkupton edhe vlerësimin, në atë shkallë që kjo është e mundur, të aftësive pjesëmarrëse. Kjo do të thotë se testimi duhet të përfshijë edhe *matjen e shkallës në të cilën nxënësit kuptojnë përdorimin e duhur të aftësive pjesëmarrëse*. Këtu duhet të sqarohet se në këtë vlerësim nuk përfshihet matja e drejtëpërdrejtë e aftësive pjesëmarrëse të nxënësve, për shembull, në qeverinë e nxënësve në shkollë ose në veprimtari të tjera publike.

Elementi i tretë janë *prirjet qytetare* dhe që përshkojnë të gjitha aspektet e qytetarisë. Në një sistem demokratik ato kanë të bëjnë me të drejtat dhe me përgjegjësitë e individëve në shoqëri dhe me çuarjen përpara të idealeve të qeverisjes demokratike.

Këtu përfshihen prirjet:

- për të qenë një anëtar i pavarur i shoqërisë,
- për të respektuar vlerat individuale dhe dinjitetin njerëzor,
- për të marrë përsipër përgjegjësitë personale, politike dhe ekonomike të qytetarit,
- për t'iu bindur “rregullave të lojës”, si pranimi i vendimit të ligjshëm të shumicës dhe respektimit të të drejtave të minoriteteve,
- për të marrë pjesë në çështjet qytetare në mënyrë të mirëinformuar, të arsyeshme dhe të efekshme
- për të nxitur dhe mbështetur funksionimin e shëndetshëm të demokracisë në vend.

Vlerësimi i prirjeve qytetare të nxënësve duhet të përqendrohet në *pyetje që kanë të bëjnë me njohjen e rëndësisë që kanë këto prirje për demokracinë*. **Vlerësimi në asnjë mënyrë nuk duhet të përfshijë pyetje që kanë të bëjnë me vlerat dhe prirjet personale të nxënësve të vlerësuar.**

Për këtë arsye, pyetjet që lidhen me prirjet qytetare duhet të lidhen me njohuritë dhe aftësitë intelektuale. Për shembull, nxënësit mund t'u kërkohet të përshkruajnë rëndësinë e dëgjimit me respekt të mendimeve dhe opinionëve të tjerëve. *Po kështu, nxënësve mund t'u matet aftësia për të vëzhguar dhe zbuluar shkallën e përputhjes së veprimtarisë së qeveritarëve ose institucioneve qeverisëse më parimet kushtetuese.*

Fitimi i njohurive, i aftësive dhe zhvillimi i prirjeve qytetare realizohen në kontekste të ndryshme si shtëpi, shkollë, bashkësi, shtet, rajon e më gjerë. Të gjitha këto përbëjnë edhe fushat kryesore në të cilat jo vetëm fitohen njohuritë dhe aftësitë por edhe zbatohen ato në praktikë.

OBJEKTIVAT PER PROGRAMIN E LËNDËS SË EDUKATËS SHOQËRORE PËR KLASAT E SHANSIT TË DYTË

KLASA E PARË

Njohuri të reja:	27 orë
Përsëritje:	3 orë
Gjithsej:	30 orë

OBJEKTIVAT E LINJAVE

I. Kush jam unë? (6 orë)

Në fund të këtij kreu nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të shprehë tiparet e tij kryesore që e dallojnë atë nga të tjerët;
- të dallojë tiparet e njerëzve që përbëjnë botën në të cilën ai jeton;
- të dallojë të përbashkëtat që gjenden ndërmjet tij dhe të tjerëve;
- të vendosë veten në një mjedis të caktuar (familje, klasë, lagje etj.) dhe ta shohë veten si pjesë e tij;
- të respektojë vetveten dhe të shprehë me besim tiparet e tij;
- të shprehë nevojat dhe dëshirat e tij;
- të dallojë nevojat dhe dëshirat e të tjerëve, të përbashkëtat dhe ato që ndryshojnë;
- të japë një shpjegim për këto ndryshime, për ndryshimet dhe të përbashkëtat që janë ndërmjet tij dhe të tjerëve etj.

Konceptet kryesore: *unë, ti, familja, klasa, lagja, nevoja, dëshira, dallimi, e përbashkëtat, e ngjashmja etj.*

II. Unë dhe të tjerët (të drejtat dhe përgjegjësitë në grup)(6 orë)

Në fund të këtij kreu nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të dallojë lidhjet që ai ka me mjedisin që e rrethon dhe me njerëzit që e përbëjnë atë:
 - njerëzit e familjes,
 - shokët (në shkollë e jashtë saj),
 - mësuesit,
 - sendet me të cilat ka lidhje në jetën e përditshme,
 - mjedisi etj.
- të dallojë dhe të vlerësojë nevojën që ai ka për njerëzit dhe mjedisin që e rrethon.
- të dallojë dhe të vlerësojë atë çfarë ai mund t'u japë të tjerëve dhe mjedisit që e rrethon;
- të vlerësojë mendimet dhe qëndrimet e veta dhe të të tjerëve;
- të shprehë përgjegjësinë e tij ndaj të tjerëve dhe mjedisit etj.

Konceptet kryesore: *Unë dhe tjetri, përgjegjësi, respekt, e drejtë, e gabuar, nevoja të përbashkëta, dëshira të përbashkëta.*

III. Të bashkëveprojmë (5 orë)

Në fund të këtij kreu nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të dallojë rolet e veçanta që çdo individ ka në shoqëri (në familje, klasë, grup, lagje etj.);
- të vlerësojë dhe të respektojë rolin e tij dhe të të tjerëve në familje, klasë, grup, lagje etj;
- të ketë besim tek vetja dhe tek të tjerët;
- të bashkëveprojë me të tjerët në familje, klasë, grup, lagje etj., për të zgjidhur probleme të ndryshme;
- të pranojë që ka njerëz që nuk kanë vështirësi për të kuptuar dhe për të bërë gjëra të ndryshme dhe të tregojë gatishmërinë për t'i ndihmuar ata etj;
- të flasë për rëndësinë e punës së përbashkët për plotësimin e nevojave dhe të dëshirave të individëve dhe të grupeve ku ata bëjnë pjesë.

Konceptet kryesore: *rol shoqëror, punë e përbashkët, punë shtëpie, punë klase, punë në komunitet, respekt, vështirësi etj.*

IV. Rregullat (5 orë)

Në fund të këtij kreu nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të dallojë rregulla të caktuara në veprimtari të ndryshme që zhvillohen në familje, klasë, shkollë, lojë etj;
- të pranojë rëndësinë e vendosjes së rregullave në një veprimtari të caktuar;
- të demonstrojë gatishmërinë e tij për të ndjekur rregullat në veprimtaritë e përditshme në familje, grup, klasë, shkollë etj;
- të vendosë rregulla të thjeshta, në bashkëpunim me të tjerët, në veprimtaritë e tij të përditshme;
- të diskutojë për rëndësinë e bashkëpunimit me të tjerët për të vendosur rregulla sa më të drejta për të gjithë etj.

Konceptet kryesore: *rregull, veprimtari shoqërore, bashkëpunim etj.*

Kreu V. Siguria dhe mbrojtja (5 orë)

Në fund të këtij kreu nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të flasë për rëndësinë e respektimit të rregullave të qarkullimit rrugor.
- të identifikojë disa nga rregullat e sjelljes së tij në:
 - shtëpi,
 - rrugë,
 - park,
 - lagje.
- të listojë sjelljet e duhura në situta të ndryshme jetësore në mjediset që ai frekuenton.

Konceptet kryesore: rrezik, rrymë elektrike, qarkullim, vija të bardha, kryqëzim, trotuar, polic trafiku, semafor etj.

KLASA E DYTË

Njohuri të reja:	27 orë
Përsëritje:	3 orë
Gjithsej:	30 orë

OBJEKTIVAT E LINJAVE

I. Individët, grupet, institucionet (5 orë)

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të diskutojë rreth ndryshimeve (në familje, klasë apo shkollë) dhe ngjashmërisë me njëri-tjetrin (p.sh., brezat në familje ndryshojnë nga mosha, detyrat që kryejnë në familje, veshja etj.);
- të përshkruajë banesën ku jeton duke e krahasuar me banesat e shokëve apo të të afërmëve të tij;
- të përshkruajë disa nga festat familjare, festat lokale (nëse ka) apo kombëtare.
- të krahasojë jetesën, banesën, veshjen, ushqimin sot dhe atë të gjyshërve të tij (nëpërmjet fotove, tregimeve);
- të analizojë ndarjen e detyrave në familjen e tij;
- të vlerësojë të drejtat dhe detyrat e pjesëtarëve të familjes (prindërve e fëmijëve).
- të përshkruajë, nëpërmjet shembujve nga jeta e përditshme, si anëtarët e familjes mbështesin njëri-tjetrin;
- të krahasojë aspekte të ndryshme të jetës në familjen e tij me atë të familjeve të tjera (ushqimi, orëditë, organizimi i kohës së lirë);
- të dallojë disa forma të komunitetit (lagje, fshati, qytete, rrethe, vendi);
- të përshkruajë format e lidhjes dhe të komunikimit mes tyre;
- të përshkruajë disa nga ndryshimet në komunitetin e tij;

- të japë shembuj që tregojnë për mënyrën e jetesës në komunitetin e tij;
- të shpjegojë rëndësinë e punës për zhvillimin e komunitetit ku jeton;
- të njohë njerëzit më të shquar të komunitetit ku jeton.

II. Njerëz, vende, mjedise (5 orë)

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të radhisë disa nga rregullat në familje;
- të thotë disa rregulla të lojës që përdor ai në mjedisin ku luan;
- të radhisë rregullat në mjediset publike (në kinema, teatër, bibliotekë, muze, ekspozitë);
- të shkruajë rregullat që përdoren në klasë (me mënyra të ndryshme paraqitjeje);
- të thotë me fjalët e veta përse i përdor rregullat në lojë;
- të veçojë njerin nga pjesëtarët e klasës që i zbaton rregullat;
- të veçojë njerin nga pjesëtarët e klasës që nuk i zbaton rregullat;
- të sjellë ilustrime nga filmat që ka parë ose nga jeta e përditshme, ku personazhi kryesor të jetë një njeri që i zbaton ose jo rregullat;
- të radhisë disa nga librat për fëmijë, ku personazhi kryesor konkretizon zbatimin ose jo të rregullave;
- të radhisë rregullat në mjedise publike;
- të thotë mendimin e tij për rregullat në familje, në mjedise publike (kinema, teatër, bibliotekë, muze, ekspozitë, palestër);
- të mbajë qëndrim ndaj personave që nuk i zbatojnë rregullat në mjedise të ndryshme;
- të përshkruajë si mund të ndryshojnë rregullat në lojë nëpërmjet votimit;
- të demonstrojë problemet që lindin si rrjedhojë e mungesës së rregullave në mjediset publike.

III. Zhvillimi individual, të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë (6 orë)

Nxënësi duhet të jetë i aftë :

- të radhisë disa nga tiparet që e karakterizojnë atë si njeri .
- të tregojë ku dallon dhe çfarë ka të ngjashme me shokët e klasës, me anëtarët e familjes (gjyshërit, prindërit, vëllezërit, motrat etj.);
- të përmendë dhe të flasë për disa nga nevojat dhe dëshirat bazë të tij dhe të shokëve duke bërë dhe dallimin ndërmjet tyre:
 - nevojat dhe dëshirat vetjake
 - nevojat e familjes
 - nevojat dhe dëshirat e shokëve etj..
- të flasë për vlerat dhe rëndësinë që kanë për të ushqimi, veshja, banesa, familja, lojërat, dashuria dhe respekti, librat, mbrojtja nga rreziqet etj;
- të thotë pse plotësimi i nevojave, si : ushqimi, veshja, banesa, lojërat, mësimi etj., përbën një të drejtë që i takon si atij, edhe të tjerëve;
- të zbulojë të drejtat që lidhen me:
 - familjen
 - punën
 - banesën
 - ushqimin
 - mirësjelljen etj..
- të flasë për rëndësinë që kanë të drejtat dhe realizimi i tyre për vete dhe të tjerët.
 - e drejta për t’u ushqyer.

IV. Pushteti, autoriteti, qeverisja (4 orë)

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë llojet e shërbimeve që kryejnë ambulanca, klinika dentare, spitali, farmacia;
- të përshkruajë mjetet kryesore të komunikimit: telefon, letër, telegram;

- të diskutojë për shërbimet e policisë rrugore, të rendit publik e financiare;
- të vlerësojë marrjen e informacionit për ngjarje të ndryshme nga radio, televizioni, gazetat;
- të demonstrojë aftësi praktike në përdorimin e telefonit dhe shkrimin e një kartoline;
- të japë shembuj të ndërhyrjes së policisë për ruajtjen e rendit në komunitet.

V. Prodhimi dhe shpërndarja (4 orë)

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të tregojë se të mirat që ata mund të kenë, janë të kufizuara;
- të pranojë se nuk mund t'i ketë të gjitha të mirat dhe shërbimet që dëshiron;
- të identifikojë disa nga të mirat dhe shërbimet që ai mund t'i ketë dhe ato që nuk mund t'i ketë;
- të identifikojë disa nga zgjedhjet që ai ka bërë dhe të shpjegojnë pse e ka bërë;
- të bëjë një listë gjërash që ai mendon se kënaq dëshirat e tij dhe të japë shembuj për to;
- të zgjedhë një lodër nga një grumbull lodrash dhe të tregojë se nga çfarë hoqi dorë dhe pse;
- të përshkruajë një situatë që kërkon një zgjedhje, një vendim dhe të tregojë koston oportune, domethënë vlerën e alternativës më të mirë nga e cila është hequr dorë, për shembull:
 - të analizojë si duhet të ndajë dhe të përdorë kohën e tij të ditës së diel duke marrë parasysh disa alternativa: të luajë me shokët, të mësojë, të shkojë të blejë diçka me prindërit etj.
 - të listojë koston e blerjes dhe të mbajtjes së një qeni ose maceje në shtëpi.
 - të listojë përfitimet e mbajtjes së një mace ose qeni në shtëpi.
- të skicojë veten si punëtor;
- të listojë shembuj të burimeve të përdorura për prodhimin e disa prej mjeteve që përdoren në familje dhe në shkollë.

VI. Rruga (3 orë)

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të dallojë rrugën, kthesat dhe përdorimet e tyre, të dallojë situatat kur mjetet mund të kalojnë rrugën e shtruar (për këmbësorët);
- të radhisë disa nga shenjat e zakonshme që ai sheh ose ka parë dhe të tregojë nëse ato gjenden në rrugën e makinës ose të këmbësorit;
- të përdorë fjalorin e duhur në një situatë rrugore të sigurt;
- të radhisë tiparet e përbashkëta të disa mjeteve, për shembull, dritat, targën etj., dhe të krahasojë masat e mjeteve të ndryshme;
- të përmendë ata që mund ta ndihmojnë të kalojë rrugën dhe të përshkruajë rolet e tyre;
- të përmendë shprehitë kryesore të nevojshme për përdorimin e rrugës kur është i shoqëruar nga një i rritur ose nga një fëmijë më i madh;
- të dallojë se disa nga mjediset e lojës janë më të sigurta se të tjerat;
- të dallojë se njerëzit mund të bëjnë zgjedhje se cilën rrugë të zgjedhin kur ndërmarrin një udhëtim;
- të identifikojë dhe të ushtrojë në praktikë, në situata të simuluar, sjellje të sigurta kur ecën me biçikletë.

KLASA E TRETË

Njohuri të reja:	27 orë
Përsëritje:	3 orë
Gjithsej:	30 orë

OBJEKTIVAT E LINJAVE

I. Individu dhe grupi (3 orë)

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë grupet sociale ku bën pjesë (familja, shkolla, grupi artistik, klubi i gjelbër, skuadra e lagjes etj.);
- të shpjegojë pse duhen respektuar rregullat në grup;
- të përshkruajë disa nga cilësitë që duhet të ketë shoku të cilat ushqejnë miqësinë dhe solidaritetin;
- të vlerësojë miqësinë dhe solidaritetin si vlera të bashkëjetesës në grup;
- të diskutojë për çështje të tilla si miqësia, toleranca, përgjegjësia etj;
- të shfaqë ndjenjën e përgjegjësisë vetjake në shtëpi, shkollë, shoqëri;
- të tregojë gadishmëri për të ndihmuar dhe respektuar shokët, të moshuarit, etj;
- të tregojë raste të shkeljes së rregullave të mirësjelljes dhe të diskutojë pasojat e tyre për vete dhe për grupin ku bën pjesë;
- të tregojë dhe të respektojë disa zakone dhe tradita të krahinës së tij;
- të demonstrojë aftësi individuale, të pranojë ide të ndryshme nga ato personalet etj.).

II. Komunikimi në shoqëri (2 orë)

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të identifikojë dhe të përshkruajë disa nga format e sotme të komunikimit në shoqëri;
- të analizojë rolin e zhvillimit të formave të ndryshme të komunikimit në zhvillimin e individit dhe shoqërisë (lajmëtari me këmbë, me kalë etj., telefoni, email);
- të përdorë mjetet e komunikimit me të tjerët (telefonin, të shkruajë letër, kartolinë, urime).

III. Rregullat (5 orë)

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë shkollën si vendi ku mësohet (vendndodhjen, madhësinë), numrin e klasave, mësuesit, organizimin etj.);
- të shpjegojë rolin e shkollës në përgatitjen për jetën;
- të shprehë mendimin e tij për rregullat e shkollës dhe të mbajë qëndrim ndaj tyre;
- të demonstrojë përgjegjësi në realizimin e detyrave të shkollës dhe veçanërisht mësimit;
- të argumentojë pse duhen zbatuar rregullat në ambientet e klasës dhe të shkollës;
- të diskutojë për rregullat me të cilat ai nuk është dakord (brenda shkollës ose klasës) dhe të mbrojë me argumente qëndrimin e tij;
- të përshkruajë si mund të ndryshojnë rregullat e klasës apo të shkollës nëpërmjet votimit;
- të përpilojë rregulla për mjedise të ndryshme;
- të rradhisë rregullat sipas përkatësisë për mjediset e shkollës dhe t'i argumentojë ato;
- të veçojë nxënësit që nuk i zbatojnë rregullat në shkollë (ç'ndodh në këto raste).

IV. Shërbimet në komunitet (3 orë)

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të dallojë disa nga shërbimet për të cilat njerëzit kanë nevojë në lagjen ku banojnë (pastrimi, mbrojtja nga zjarri, parqet pushimi, kënde lojërash etj);
- të dallojë disa nga institucionet që mund të ofrojnë shërbime për komunitetin ku jeton (për shembull të tregojë se ç' shërbime mund ofrojnë policia, zjarrfikësat etj);
- të përshkruajë disa nga veprimet që janë të domosdoshme për të shfrytëzuar shërbimet e komunitetit ku jeton në rast nevoje;
- të tregojë se çfarë mund dhe duhet të bëjnë famijët dhe banorët e tjerë të komunitetit për të rritur cilësinë e shërbimeve dhe të përfitimit prej tyre;
- të përfshihet në veprimtari në dobi të komunitetit (ruajtja e gjelbërimit, në ndihmë të pleqve, etj. etj.) për të rritur sasinë e shërbimeve në komunitet.

V. Rruga (5 orë)

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të dallojë rreziqet ose pengesat e ndryshme me të cilat mund të ndeshen kalimtarët në trotuare si për shembull objekte të ndryshme etj, dhe të përcaktojë rrugë më të sigurtë për të në mjedisin ku jeton;
- të dallojë rrugët e qeta nga ato të ngarkuara si dhe disa prej rreziqeve që lidhen me to;
- të përdorë si duhet atë pjesë të fjalorit të trafikut që lidhet me të si përdorues rruge;
- të flasë për marrëdhëniet ndërmjet masës dhe distancës dhe të dallojë disa nga problemet që lidhen me to;
- të zbatojë me ndihmën e të rriturve rregullat e kalimit të rrugës vetëm.
- të shpjegojë rreziqet e lojës në rrugë;
- të përshkruajë disa nga zgjidhjet e mundshme që i ofrohen atij në udhëtimet e përditshme;
- të përmendë disa nga rreziqet e mundshme të pasagjerëve dhe të flasë për

- mundësinë e rritjes së sigurisë së pasagjerëve;
- të flasë për rëndësinë që ka mbajtja parasysh e shpejtësisë dhe distancës për rritjen e sigurisë në rrugë;
- të përgatisë një kënd në klasë për paraqitjen e shenjave të qarkullimit rrugor.

VI. Shëndeti dhe mjedisi (5 orë)

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë ndryshimet në stinë dhe në vite;
- të diskutojë se si ndikon mjedisi i gjelbër në shlodhjen e njeriut;
- të vëzhgojë raste të keqpërdorimit të mjedisit (në shkollë, në institucione publike, etj.);
- të kryejë veprime të ndryshme dhe konkrete për përmirësimin e situatës mjedisore (në klasë, në shtëpi apo mjedisin përreth);
- të përshkruajë kujdesin që tregon për trupin dhe dhëmbët;
- të përshkruajë përdorime të thjeshta të barnave mjekësore;
- të planifikojë një dietë ushqimore që redukton rreziqet e mbipeshës ose të nënpeshës;
- të flasë për rolin që ka sporti dhe shetitjet në ajër të pastër për shëndetin e njeriut;
- të vlerësojë dhe të orientohet në jetën e përditshme për përdorimin e drejtë të institucioneve të ndryshme shëndetësore;
- të flasë për rolin e institucioneve shëndetësore në jetën e shoqërisë;
- të përshkruajë disa nga organizmat vullnetare shëndetësore në komunitetin e tij;
- të diskutojë për përvojën vetiake në marrëdhënie me këto institucione;
- të demonstrojë aftësi praktike në shkrimin e letrës, telegramit, kartolinës.

VII. Prodhimi dhe shpërndarja (4 orë)

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë se si njerëzit jetojnë dhe punojnë në një familje;
- të thotë me fjalët e tij se ç'është familja si një njësi ekonomike;
- të identifikojë se nga ç'burime vijnë paratë në familjen e tij;
- të përmendë rolin e kursimit të parave personale dhe të familjes;
- të tregojë varësinë e anëtarëve të familjes nga punët e ndryshme;
- të shpjegojë ndryshimet ndërmjet dëshirave dhe nevojave;
- të identifikojë disa nga profesionet e njerëzve që njih;
- të përshruajë dhe të përdorë disa nga veglat më të domosdoshme për mirëmbajtje në familje (pinca, kaçavida etj);
- të tregojë se përdorimi i veglave kërkon aftësi shprehi të caktuara;
- të lidhë krijimin e shprehive për punë me nevojën e arsimit etj.

KLASA E KATËRT

Njohuri të reja:	27 orë
Përsëritje:	3 orë
Gjithsej:	30 orë

OBJEKTIVAT E LINJAVE

I. Kultura (4 orë)

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të identifikojë raste dhe çështje që lidhen me këndvështrimet e ndryshme kulturore brenda grupit shoqëror ku jeton;
- të shprehë mendime pozitive rreth vetes dhe aftësive të të tjerëve;
- të lidhet me situatat e jetës së përditshme dhe të shpjegojë në mënyrë të thjeshtë ndryshimet kulturore ndërmjet grupeve të ndryshme;
- të pranojë dhe të vlerësojë që perceptimi i tij për njerëzit dhe ngjarjet që vijnë nga sfonde të ndryshme kulturore ndikon në pasurimin e jetës shpirtërore të tij.

II. Njerëz, vende dhe mjedise (4 orë)

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të identifikojë mjetet e komunikacionit, shenjat e trafikut dhe rregullat e qarkullimit rrugor;
- të identifikojë llojet e rrugëve dhe veçoritë e tyre;
- të dallojë vednet e sigurta për të kaluar rrugën , si dhe të bëjë krahasimin midis tyre;
- të planifikojë vende të sigurta për kalimet e përditshme;
- të tregojë funksionet e tabelave të ndryshme të qarkullimit rrugor.

III.Zhvillimi individual dhe identiteti. (5 orë)

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të identifikojë veten si individ unik;
- të identifikojë aftësitë dhe shprehitë individuale;
- të shpjegojë që ai është vazhdimisht në zhvillim dhe ndryshim;
- të shprehë gjendjen dhe ndjenjat e veta;
- të demonstrojë aftësi për të bashkëpunuar;
- të demonstrojë aftësinë për të përzgjedhur dhe të diskutojë arsyet e zgjedhjes së bërë;
- të pranojë nevojën e rregullave në çdo hap që hedh.;
- të pranojë që nevojat e të tjerëve mund të jenë më urgjente se të tijat;
- të marrë përgjegjësi personale për veprimet që ai kryen. Të identifikojë dhe të krahasojë ndryshimet që ka pësuar ai ose njerëzit e tjerë, duke iu referuar kujtimeve, fotove, filmave dhe dokumenteve të tjera;
- të shpjegojë sesi ndryshimet ndikojnë në jetën e tij dhe të njerëzve të tjerë të komunitetit.

IV. Individët, grupet dhe institucionet (5 orë)

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përshtatet me rolet e ndryshme brenda grupeve;
- të demonstrojë ndërgjegjësim rreth faktorëve specifikë (si barazia gjinore), të cilët ndikojnë në marrëdhëniet ndërpersonale;
- të komunikojë dhe të ndërveprojë me personat e njohur;
- të fillojë të identifikojë vlerat të cilat janë të rëndësishme në shtëpi, shkollë dhe komunitet;
- të demonstrojë respekt dhe tolerancë ndaj të tjerëve;
- të identifikojë ndërmjet tyre qeverisjen vendore dhe atë shtetërore;
- të thotë emrat e personave përgjegjës: kryetar komune, kryetar bashkie, kryeministër dhe president;
- të dallojë nga uniforma llojet e policisë në komunitetin ku jeton;
- të paraqesë të drejtat dhe përgjegjësitë individuale në grupin ku jeton.

V. Prodhimi shpërndarja konsumi.(5 orë)

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të shpjegojnë se si ata dhe të tjerët mund të fitojnë më shumë duke zhvilluar dhe fuqizuar aftësi të veçanta.

Për këtë ata duhet të jenë të aftë:

- të identifikojnë disa të rritur në familje, në shkollë ose në lagje që janë të specializuar për të prodhuar një të mirë (bukëpjekësi, këpucari, mësuesi, polici etj) dhe të dallojnë të mira ose shërbime që këta njerëz i konsumojnë por nuk i prodhojnë vetë. (për shembull, bukëpjekësi përdor këpucë që nuk i ka prodhuar vetë).
- të marrin pjesë në një linjë të simuluar të montimit të të produkti dhe të dallojnë pjesët që montohen dhe detyrat e veçanta që përfshihen në të. (për shembull, një lodër e zbërthyer në pjesë të prodhuara nga detyra të veçanta).
- të punojnë në mënyrë individuale për të prodhuar një produkt të thjeshtë dhe më pas ta bëjnë këtë si anëtarë të një grupi të vogël që prodhon të njëjtin produkt.

- të krahasojnë shkallën e specializimit dhe të ndërvarësisë së një njeriu për shembull, që jeton në ishullin e Sazanit me një tjetër që jeton në malet në veri të Shqipërisë.
- të identifikojë mjete teknike të cilat kanë ndryshuar jetesën e njerëzve dhe të zbulojë kontributet e shumta për prodhimin e tyre

VI. Ideat dhe praktikat e shoqërisë(4 orë)

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të identifikojë elemente të përbashkët ose të ndryshëm, që lidhen me mënyrën e organizimit të jetesës në grup, ndërmjet komunitetit ku bën pjesë dhe të gjithë vendit ;
- të përcaktojë për çdo të drejtë të tij detyrat dhe përgjegjësitë përkatëse;
- të dallojë paragjykimet e ndryshme që mund të bëhen shkas për prekjen e racës, seksit, nivelit ekonomik të pjesëtarëve të grupimit ku jeton;
- të përshkruajë simbolet e atdheut (flamur, himn kombëtar, festa kombëtare, monumente), si dhe ato të komunitetit ku jeton;
- të identifikojë dhe zbatojë në praktikë forma të caktuara të diskutimeve dhe pjesëmarrjes publike në përputhje me nevojat e komunitetit që i përket.

KLASA E PESTË

Njohuri të reja	27 orë
Përsëritje:	3 orë
Gjithsej:	30 orë

OBJEKTIVAT E LINJAVE

I. Familja (4 orë)

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë si ka ndryshuar historikisht familja.
- të përshkruajë funksionet që kryen familja dhe të diskutojë konkretisht rreth tyre.

- të japë shembuj të mosmarrëveshjeve në familje si edhe mendime, propozime, e rrugëzgjdhje të reja si domosdoshmëri për mbarëvajtjen e familjes.

II. Komuniteti (6 orë)

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të tregojë ç'kupton me *grup shoqëror* dhe të emërtojë disa prej tyre.
- të vendosë sipas rëndësisë karakteristikat e grupit shoqëror.
- të përshkruajë grupet ku bën pjesë dhe të përshkruajë rolet që luan ai gjatë ditës.
- të sqarojë kuptimin e vetëpërmbytjes.
- të argumentojë me shembuj konkretë nga jeta e tyre e përditshme në shkollë e në komunitetin ku banon pasojat pozitive dhe negative të vetëpërmbytjes.
- të demonstrojnë vlera të tilla si e vetëpërmbytja e kompromisi në grupet ku bën pjesë.
- të sqarojë kuptimin e fjalës *komunitet*, të dallojë llojet e komuniteteve dhe të përcaktojë nga se ndryshojnë ato nga njeri tjetri.
- të përshkruajë aspekte të ndikimit të komunitetit tek njerëzit si p.sh. për të mësuar për ta bërë jetën më të gëzueshme, për një komunikim më të mirë etj.
- të përshkruajë se çdo të thotë të jesh qytetar i mirë në familje, në shkollë e në komunitet.
- të vlerësojë punën e qytetarëve për përmirësimin e jetesës në komunitet.
- të tregojë se ç'kupton me *grup vullnetar*, t'a dallojë atë nga grupi shoqëror duke e ilustruar me shembuj.
- të rradhisë grupet vullnetare që njeh, të përshkruajë një grup vullnetar në të cilin bën pjesë vetë ose shokët e tij dhe të flasë për rëndësinë që ka ai për komunitetin.
- të dallojë dhe të përshkruajë disa nga punët vullnetare që fëmijët dhe të rriturit mund të bëjnë për ta bërë jetën në komunitet më të mirë
- të diskutojë për rolin e një qytetari të arsimuar në përparmin e komunitetit dhe të shoqërisë në përgjithësi.

III. Qeverisja (5 orë)

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë organizimin e pushtetit vendor në komunë, bashki e prefekturë.
- të përshkruajë mënyrën se si organet e qeverisjes vendore zgjidhen nga komuniteti dhe, në të njëjten kohë, përgjigjen para tij.
- të krahasojë procedurën e zgjedhjeve në klasën e tij me atë që përdoret për zgjedhjen e qeverisjes lokale.
- të diskutojë për rëndësinë e procedurës së zgjedhjeve dhe për dhënien llogari të njerëzve të zgjedhur para zgjedhësve.

IV. Edukim rrugor (7 orë)

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të dallojnë tiparet kryesore të llojeve të ndryshme të automjeteve dhe të shqyrtojnë rreziqet që paraqesin për këmbësorët “pikat e verbra” .
- të diskutojnë për rreziqet që paraqet kalimi prapa ose ndërmjet makinave të parkuara dhe të praktikojnë situata konkrete.
- të analizojë konfliktet që lindin ndërmjet përdoruesve të ndryshëm të rrugës, për shembull ndërmjet çiklistëve dhe këmbësorëve në një vend për këmbësorë.
- të shpjegojë pasojat që kanë për vete dhe për të tjerët përdorimi prej tyre i kryqëzimeve dhe rrugëve të mbrojtura dhe të sigurta, duke vlerësuar pasojat e mundshme të moszbatimit të tyre.
- të diskutojë për ndikimin që ka sjellja e pasagjerëve për vete dhe për të tjerët (edhe për automjetet)
- të japë përfundimet e tij nga informacionet që merr për rrugët dhe ngjarjet që ndodhin ne to.

V. Edukim ekonomik (5 orë)

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të zhvillojë një plan të vogël biznesi për prodhimin e një produkti që konsumohet prej tyre. Për këtë ai duhet:
- të dallojë disa nga produktet ushqimore që përdoren më shumë nga fëmijët, për shembull, hamburger, patatina etj. dhe të zgjedhë njërin prej tyre për shembull, hamburgerin
- të dallojë **burimet** e nevojshme për prodhimin e tij
 - Lokali (qeraja e lokalit)
 - Lënda e parë (buka, mishi, salca, patatja, qeset mbështjellëse etj)
 - Fuqia punëtore (sa veta do të marrin pjesë për prodhimin e tij)
- të dallojë **llojet** e punës për prodhimin e hamburgerit, si për shembull:
 - Organizimi i punës
 - Furnizimi i lëndë së parë
 - Pastruesi dhe përgatitësi i lëndës së parë
 - Gatimi (i salcës, i mishit etj) etj.
- të studiojë **vendin**, numrin e mundshëm të fëmijëve që mund të kalojnë dhe të blejnë hamburger në atë vend
- të llogarisë cilat **shpenzime** tipike bëhen për të prodhuar një hamburger.
- të dallojë që kosto e një hamburgeri pakësohet sa më shumë hamburgera të prodhohen dhe të shiten.
- të llogarisë fitimin nga shitja:
 - E një hamburgeri
 - E dhjetë hamburgerave
 - E njëzet hamburgerave